



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.61, datë 27.11.2025

“PËR MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURËS SË BINJAKËZIMIT MIDIS BASHKISË SKRAPAR DHE KOMUNËS SAN BENEDETTO ULLANO, ITALI”.

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 27.11.2025, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenin 54 të këtij ligji, që parashikon kompetencat e bashkive në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, Interesin e përbashkët për nxitjen e zhvillimit lokal, shkëmbimeve kulturore, turistike dhe institucionale, marrëdhëniet historike e kulturore midis komuniteteve të zonave malore të Italisë së Jugut dhe Shqipërisë. **Konventa Evropiane e Autonomisë Vendore** e ratifikuar nga Shqipëria. Parimet e Kartës së Binjakëzimit të Bashkive Evropiane. Parimet e bashkëpunimit ndërkufutar dhe ndërkombëtar në kuadër të bashkimit Evropian.

VENDOSI:

1. Miratimin e fillimit të procedurës së binjakëzimit midis Bashkisë Skrapar dhe Komunës San Benedetto Ullano (Kalabria, Itali).
2. Vendosjen e kontakteve formale ndërmjet dy njësive vendore
3. Shkëmbimin e dokumentacionit zyrtar dhe të qëllimeve të bashkëpunimit
4. Përcaktimin e fushave të interesit të përbashkët
5. Hartimin e projekt-marrëveshjes së binjakëzimit

Vendimi u miratua me 9 Vota pro, vota kundër - s'ka , abstenim – s'ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Elsa PETRITAJ

